



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:237057
Datë: 16.01.2024
Numri i dokumentit: 05196231

PA1.nr. 942/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me praktikantin gjyqësor Arben Arifi, si procesmbajtës në lëndën penale ndaj të akuzuarve B.M. dhe A.J., që të dy nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë në tentativë në bashkëkryerje nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, për të vendosur sipas ankesave të mbrojtësve së të akuzuarve, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, P.nr. 166/2022 të datës 12.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 11.Janar. 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve B.M. dhe A.J., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, P.nr. 166/2022 të datës 12.06.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtri, P.nr. 166/2022 të datës 12.06.2023 të akuzuarit B.M. dhe A.J. janë shpallur fajtorë për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë në tentativë në bashkëkryerje nga neni 315 par.1 pika 1.1 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, për të cilën secilit veç e veç iu është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej nga 1 (një) viti e të cilat dënime me burgim do të ekzekutohen

pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe dënime me gjobe ne shume prej nga 1,000 (njëmijë) euro me kusht se dënimet me gjobë nuk do te ekzekutohen nëse te akuzuarit ne afat prej 1 viti pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi nuk kryejnë tjetër vepër penale.

Shpenzimet e procedurës penale eshte vendosur qe te bien ne barrë të mjeteve buxhetore te gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesa kanë ushtruar :

Mbrojtësi i të akuzuarit B.M. – av.Nexhat Beqiri nga Vushtrria, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit për veprën penale të kryer të i shqiptohet dënim më i ulët me burgim se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë apo që dënimi me burgim t’i kushtëzohet e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.J. – av.Naser Azemi nga Vushtrria, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke propozuar qe aktgjykimi i ankimuar i gjykatës se shkalles se pare te ndryshohet, dhe te akuzuarit për veprën penale të kryer të i shqiptohet dënim më i ulët me burgim se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë apo qe dënimi me burgim t’i kushtëzohet, e me të cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve, me shkresën e vet PPA.II.nr. 979/23 të datës 02.08.2023 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës, ankesat e mbrojtësve së të akuzuarve t’i refuzoj si te pabazuara ndërsa aktgjykimin e ankimuar të gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit ne pajtim me nenin 390 paragrafi 1 te KPPRK-se, në të cilën prezantuan mbrojtësi i të akuzuarit B.M., av.Nexhat Beqiri si dhe i akuzuari A.J., ndërsa palët e tjera munguan edhe pse te njoftuara ne menyre te rregullt, andaj seanca e kolegjit u mbajt ne pajtim me nenin 390 par.4 të KPRK-së Mbrojtësi i të akuzuarit B.M., av.Nexhat Beqiri, pas elaborimit te ankesës ne tërësi mbeti pranë ankesës se parashtruar me shkrim dhe propozoi qe e njëjta te aprovohet si e bazuar. I akuzuari A.J. ne tërësi mbeti pranë ankesës se parashtruar nga mbrojtësi i tij av.Naser Azemi dhe propozoi qe ankesa te aprovohet si e bazuar.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, konform nenit 394 par.1 të KPPK-së i shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore te mbrojtësve së të akuzuarve, dhe gjeti se:

- **Ankesat nuk janë te bazuara.**

Edhe pse aktgjykimi i Gjykatës se shkalles se pare nuk është atakuar lidhur me bazën ankimore shkeljet esenciale te dispozitave te procedurës penale, Gjykata e Apelit e vlerësoi edhe ne ketë aspekt dhe konstatoi se i njëjti nuk është i përfshire me shkelje esenciale te dispozitave te procedurës penale te natyrës absolute e te cilat Gjykata e Apelit i konstaton sipas detyrës zyrtare, e te cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit.

Gjendja faktike nuk ka qenë objekt shqyrtimi ngase të akuzuarit B.M. dhe A.J., gjatë shqyrtimit fillestar të datës 05.06.2023 në bazë të nenit 242 të KPRK-së e kanë pranuar fajësinë për veprën penale për të cilat janë akuzuar, i cili pranim është bërë në mënyrë vullnetare nga të akuzuarit pas konsultimit të mjaftueshëm me mbrojtësit e tyre. Pranimi i fajësisë ka mbështetje në faktet që përmban aktakuza dhe provat që gjenden në shkresat e lëndës. Nga një gjendje e tillë e vërtetuar faktike del që në rastin konkret drejtë është aplikuar edhe ligji penal.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit B.M., av.Nexhat Beqiri, me ankesë pretendon se gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim efektiv dhe me gjobë të kushtëzuar nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, pendimin, keqardhjen, kërkim faljen, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, e sikur këto rrethana të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur të akuzuarit është dashur që t'i shqiptohet dënim më i ulët me burgim apo dënim me burgim të kushtëzuar dhe me gjobë të kushtëzuar se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e më te cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-se, andaj ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të aprovohet si e bazuar.

Sa i përket vendimit mbi sanksionin penal, mbrojtësi i të akuzuarit A.J., av.Naser Azemi, me ankesë pretendon se gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim efektiv dhe me gjobë të kushtëzuar nuk i ka vlerësuar në mënyrë të duhur rrethanat lehtësuese si pranimin e fajësisë në mënyrë vullnetare, pendimin, keqardhjen, kërkim faljen, premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej vepra penale, pastaj se vepra penale është kryer në moshë shumë të re (rreth 20 vjeçar) e sikur këto rrethana të ishin vlerësuar në mënyrë të duhur të akuzuarit është dashur që t'i shqiptohet dënim më i ulët me burgim apo dënim me burgim të kushtëzuar dhe me gjobë të kushtëzuar se sa dënimi i shqiptuar nga ana e gjykatës së shkallës së parë, e më te cilin dënim do të arrihej qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-se, andaj ka propozuar që ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit të aprovohet si e bazuar.

Gjykata e Apelit vlerësoi pretendimet ankimore të mbrojtësve të të akuzuarve lidhur me sanksionin penal dhe duke i patur parasysh rrethanat e cekura më lartë dhe rrethanat e rastit konkret konstaton se Gjykata e shkalles se pare me rastin e shqiptimit të dënimeve me burgim efektiv dhe me gjobë të kushtëzuar, drejte dhe në mënyrë të plote i ka vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe renduese nga neni 69 dhe 70 të KPRK-se të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, andaj konstaton se dënimet e shqiptuara ndaj të akuzuarve nga gjykata e shkallës së parë janë në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarve dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale të kryera, andaj i refuzoi si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve, e me bindje se me dënimet e shqiptuara nga ana e Gjykatës së shkalles se pare, do të arrihet qëllimi i dënimit i parapare me nenin 38 të KPRK-së, respektivisht parandalimi i kryerësve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëhet rehabilitimi i tyre, parandalimi i personave tjerë nga kryerja e veprave penale dhe ngritja e moralit për respektimin e ligjit.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.942/23 më 11.01.2024

Procesmbajtësi
Arben Arifi

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetar i kolegjit
Ferit Osmani

Zyhdi Haziri
